

AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-72/1

Në bazë të Nenit 15.2.3 dhe nenit 16. 3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, si dhe në bazë të Rregullores 01/2016 për procedurat e rekrutimit, nominimit dhe emërimit të Menaxhmentit dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, pas diskutimeve nga Bordi dhe propozimit nga Kryesuesi, Bordi i Drejtorëve të AKP-së përmes procedurës me shkrim sipas nenit 9.5 të Statutit të Bordit të Drejtorëve të AKP-së me datën 09 Shkurt 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Bordi i AKP-së aprovon Përshkrimin e Punës për pozitën Zëvendës Drejtor Menaxhues – Shitje të Agjencisë të paraqitur përmes kësaj procedure të votimit me shkrim.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, 09 /02/2016




Petrit Gashi

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-72/2

Në bazë të nenit 15.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034 dhe nenit 5.2 të Statutit të Bordit të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 25 shkurt 2016 nxjerr këtë:

V E N D I M


- I. Procesverbali i mbledhjes të Bordit të AKP-së të mbajtur më 28 janar dhe 2 shkurt 2016 i paraqitur për aprovim, nëpërmjet kësaj aprovohet si procesverbal i mbledhjes të Bordit të cekur më lartë.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25 / 02 / 2016



Petrit Gashi

Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-72/3


Në bazë të neneve 11.3, 15.1, 15.2.3 dhe 16.3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, si dhe duke marrë parasysh vendimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë P.nr.904/2013 të datës 27 maj 2014, i vërtetuar me vendimet e Gjykatës së Apelit PA1.nr.1166/2014 të datës 3 shkurt 2015 dhe me PA1.nr.1376/15 të datës 26 janar 2016, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 25 shkurt 2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Naim Avdiu shkarkohet nga pozita e Zëvendës Drejtorit Menaxhues, Divizioni i Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25 / 02 / 2016


Petrin Gashi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-72/4

Në bazë të Nenit 15.2.3 dhe nenit 16. 3 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, si dhe në bazë të Rregullores 01/2016 për procedurat e rekrutimit, nominimit dhe emërimit të Menaxhmentit dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 25 shkurt 2016 nxjerr këtë:

V E N D I M


- I. Aprovohet përshkrimi i punës për Zëvendës Drejtor Menaxhues-Likuidim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit sipas materialit të paraqitur në këtë pikë të diskutimit.
- II. Të shpallet konkurs publik për Zëvendës Drejtor Menaxhues-Likuidim të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, sipas Rregullores 01/2016 për procedurat e rekrutimit, nominimit dhe emërimit të Menaxhmentit dhe Drejtorit të Sekretarisë Ekzekutive të AKP-së.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25 / 02 / 2016



Petrit Gashi

Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-72/5

Në bazë të Nenit 15.2.5 dhe nenit 6.1.5 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034, pas diskutimeve lidhur me NSH Pallati i Rinisë, Prishtinë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 25 shkurt 2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. NSH Pallati i Rinisë, në Prishtinë të vendoset nën Administrimin Direkt të AKP-së.
- II. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.


Prishtinë, më 25 / 02 / 2016



Petrit Gashi

Kryesues

Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-72/6

Në bazë të Nenit 15.1 dhe nenit 15.2.1 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034, pas diskutimeve lidhur me Komitetet/Komisionet e Bordit, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 25 shkurt 2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet propozimi për kompensim të anëtarëve të Komisioneve/Komiteteve të Bordit. Kompensimi llogaritet 1+1, (një ditë angazhim/përgatitje të mbledhjes plus një ditë mbajtje të mbledhjes).
- II. Shuma e kompensimit për një ditë të llogaritur është € 241.66, shumë kjo e përcaktuar duke u bazuar në kompensimin që anëtarët e Bordit e pranojnë për një ditë pune sipas Rregullores për kompensim të anëtarëve të Bordit e datës 23 korrik 2014.
- III. Ky vendim zbatohet nga momenti i themelimit të Komiteteve/Komisioneve të Bordit në mbledhjen e datës 28 janar dhe 2 shkurt 2016.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25 / 02 / 2016




Petrit Gashi

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO

Nr. Ref. BD-72/7


Në bazë të neneve 5, 6 dhe 15.2.17 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr. 04/L-034, pas diskutimeve sipas rekomandimit të Komisionit për shqyrtimin e statusit të ndërmarrjeve të caktuara (KPS), Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 25 shkurt 2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohen raportet përfundimtare dhe rekomandimet e Komisionit për Shqyrtimin e KPS (SDR) të bashkangjitura në Shtojcë të këtij vendimi.
- II. Miratohet Raporti shtesë lidhur me pikat e veprimit të mbledhjes së Bordit të Drejtorëve të datës 23 korrik 2014, si në vijim:
Raporti shtesë për përcaktimin e statusit të personit juridik të ndërmarrjes "Banka e Lubjanës"- Banka Themelore, Prishtinë KPS (SDR) 1374/PRN133 i përgatitur nga Departamenti Ligjor dhe Departamenti për Buxhet dhe Financa, AKP i bashkangjitur në materialin sipas kësaj pike.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25 / 02 / 2016


Pëtnit Gashi
Kryesues
Bordi i Drejtorëve
Agjencia Kosovare e Privatizimit



AGJENCIA KOSOVARE E PRIVATIZIMIT
KOSOVSKA AGENCIJA ZA PRIVATIZACIJU
PRIVATISATION AGENCY OF KOSOVO


Nr. Ref. BD-72/8

Në bazë të neneve 6.1.14 dhe 15.2.9 të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit Nr.04/L-034 dhe nenit 5.3 të Politikave Operacionale të Agjencisë Kosovare të Privatizimit pas shqyrtimit të propozimit të Menaxhmentit të AKP-së sipas kërkesës së Ministrisë së Administratës Publike për qiradhënie të objektit të NSH "Trepça-Ndërmarrje nën Administrim të AKP-së", ish Nësia "Ndërmarrja e Kontabilitetit Elektronik" në Mitrovicë, Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me datën 25 shkurt 2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Administratës Publike e datës 24 shkurt 2016 për ofertë për qiramarrjeje për objektin e NSH "Trepça - Ndërmarrje në Administrim të AKP" me adresë rr. "Filip Vishnjq" nr. 4 Mitrovicë, ish njësia "Ndërmarrja e kontabilitetit elektronik" në kuadër të Trepçës, e cila aktualisht nuk shfrytëzohet për nevoja operative të ndërmarrjes.
- II. Bordi e autorizon Menaxhmentin që të përcjell kërkesën tek Ndërmarrja.
 - a) Menaxhmenti të konfirmojë pajtueshmërinë e Ndërmarrjes për lëshim me qira të objektit.
 - b) Menaxhmenti të konfirmojë se çmimi i qirasë është në kuadër të kompetencave të Administratorit konform Ligjit për Riorganizim të Ndërmarrjeve të Caktuara (Ligji 04/-L-035).
 - c) Vetëm në rast se kushtet e lartpërmendura plotësohen, Ndërmarrja mund të ofertojë për qiradhënie dhe të negociojë me MAP me qëllim të arritjes së marrëveshjes, e cila mund të finalizohet me miratimin e Menaxhmentit të AKP.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e aprovimit nga Bordi i Drejtorëve.

Prishtinë, më 25 / 02 / 2016



Petrit Gashi

Kryesues

Bordi i Drejtorëve

Agjencia Kosovare e Privatizimit